

Konkurs Termt e Referencës

Organizata	Handikos Ferizaj (Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara)
Qëllimi i Angazhimit	Ofrimi i trajnimit me psikolog të shkollave të mesme dhe hartimi i prezantimit mbi qasjen dhe praktikat e mira që mund të përdoren kundër diskriminimit dhe stigmatizimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjediset e shkollës.
Tipi	Kompani/Individuale
Lokacioni	Ferizaj, Kosovë
Kohëzgjatja	3 ditë

Handikos Ferizaj

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare e përkushtuar në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe avokimit. Handikos Ferizaj punon për së afërmi me komunitetin, organizata të tjera si-motra, institucionet shëndetësore dhe autoritetet lokale e qendrore, për t'i shërbyer në mënyrë sa më efektive dhe të qëndrueshme përfituesve të saj.

Qëllimi i përgjithshëm

Handikos Ferizaj që nga Shkurti 2024 është duke e implementuar Projektin “**Angazhimi i të rinjve, për një shoqëri gjithëpërfshirëse pa diskriminim**” i mbështetur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe financuar nga Qeveria e Japonisë, në kuadër të Fondit Japonez për Zhvillim Social, i administruar nga Banka Botërore.

Me qëllim të realizimit të trajnimit me psikolog të Shkollave të Mesme dhe hartimi i prezantimit mbi qasjen dhe praktikat e mira që mund të përdoren kundër diskriminimit dhe stigmatizimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjediset e shkollës, Handikos Ferizaj është në kërkim të një Eksperti/e apo Kompanie, i/e cila do të jetë përgjegjës/e për fasilitimin e punëtorisë dy ditore dhe një ditë përgatitjen e prezantimit.

Përmes këtij projekti synojmë të përmirësojmë qasjen ndaj të rinjve me aftësi të kufizuara, e të cilët shpesh janë grupi më i marginalizuar, përballë stigmës, diskriminimit dhe ndarjes në komunitetin e tyre. Ata shpesh janë të privuar nga arsimi dhe të drejtat për shërbimet e tjera themelore, dhe janë dukshëm më të cenueshëm sesa bashkëmoshatarët e tyre ndaj dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit.

Për këtë arsye ne po kërkojmë individë të kualifikuar, entuziast dhe të dedikuar në punë që të bëhen pjesë e ekipit tonë:

Një (1) Expert/e lokal;

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Trajnimi i stafit me Psikolog të Shkollave të Mesme të Komunës së Ferizajt;
- Hartimi i prezantimit mbi qasjen dhe praktikat e mira që mund të përdoren kundër diskriminimit dhe stigmatizimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjediset e shkollës.

Kualifikimet dhe eksperiencia

- Diplomë Universitare në shkenca sociale, juridik apo fushë të ngjashme
- Përvojë paraprake në trajnim, analizë dhe mbledhjen e të dhënave, me tematikë të ngjashme;
- Njohuri të çështjes së aftësisë së kufizuar në kontekstin vendor;
- Shkathtësi të larta hulumtuese në identifikimin e praktikave/modeleve të cilat përdoren në rajon dhe botë në këtë fushë;
- Shkathtësi ndër personale dhe të komunikimit;
- Ndjeshmëri ndaj kontekstit dhe situatave të ndryshme me qasje të hapur ndaj diversitetit;

Kohëzgjatja dhe pritjet

Experti do të angazhohet me një periudhë prej tri (3) ditëve në muajin Mars 2024

Aplikuesit duhet të dorëzojnë

- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë koston financiare të kalkuluar për ditët e angazhimit;
- Një letër interesi që paraqet arsyet që ai/ajo është i/e përshtatshëm dhe ka njohuri dhe eksperiencë në fusha të ngjashme;
- Curriculum Vitae (CV);

Pagesa

Pagesa për Expert/e, do të bëhet pas përfundimit të përgjegjësive të kontraktuara;

Procedurat e aplikimit

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në e-mail adresën: handikosferizaj@gmail.com me subjektin *Aplikoj për "expert/e"*, Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është **20.02 2024 ora 23:59h.**

Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të kontaktohen. Gjatë gjithë procesit nuk ofrohen informata me telefon.